VENDIM
Nr. 17, datë 31.1.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" SHPK, NR. 277, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 38, DATË 18.3.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 5, pika 1, germa "d"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 24/3 prot., datë 22.1.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93 prot., datë 17.1.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 4.11.2014, është regjistruar pranë QKB-së si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me numër identifikimi (NUIS) L42304017T.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Referuar sa më sipër, konstatohet se shoqëria "Albanian Energy Supplier" sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Aplikimi i shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e") është plotësuar pjesërisht;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar, apo të përcjellë jo në formën e kërkuar nga ligji, e që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 2,

- germa "d" (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë),

- do t'i kërkohet shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimin e Gjykatës dhe të Prokurorisë për përfaqësuesen ligjore të shoqërisë.

Nenin 9, pika 4.7,

- germa "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie),

- shoqëria ka deklaruar të njëjtin kapital financiar për qëllime të aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit dhe asaj të tregtimit. Do t'i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e secilës veprimtari më vete,

- germa "c" (lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur),

- shoqëria në plotësim të kësaj kërkesë të rregullores ka listuar disa data kontratash, por jo të dhënat përkatëse të këtyre kontratave;

- germa "d" (Informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave),

- do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE, informacion të detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave.

germa "e" (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi),

- do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE informacion në lidhje me sistemin IT,

- germa "g" (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve),

- do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE dokumentacionin në lidhje me disponimin e zyrave.

Për sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

- Rezulton se shoqëria aplikuese nuk është debitore sa u përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 277, seria FK15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 38, datë 18.3.2015.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti